

Hapet thirrja për bursa në kuadër të programit Erasmus + në Universitetin e Perugias, në Itali, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për studentët për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin e Perugias, në Itali në kuadër të programit Erasmus +, për studentët, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

<https://www.unipg.it/en/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor;
- Master;

Kohëzgjatja e bursave:

- 1 semestër;

Fushat e studimit:

-Biologji dhe shkencat e saj;

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti i Perugias klikoni në linkun:

<https://www.unipg.it/en/ects/ects-course-catalogue-2021-22>

<https://www.unipg.it/en/ects/courses-held-in-english>

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze / italiane);
- Listë notash (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze / italiane);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze / italiane);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/ Italisht A2 në varësi të programit të studimit);
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Before the Mobility’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti ‘Learning Agreement’ tek seksioni ‘Commitment’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studentit bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

- CV (në gjuhën angleze / italiane);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit të nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze / italiane);
- Listë notash e nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze / italiane);
- Listë notash e nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze / italiane);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze / italiane);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/ Italisht A2 në varësi të programit të studimit);
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloheni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studentit bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx

Afati për aplikim: 03 Mars 2022

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!